



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

**V E N D I M**

**Nr.1532, datë 18.03.2011**

**Për**

**“Miratimin e projektregullores “Për Licencën e Përgjithëshme për ofrimin e shërbimeve postare” dhe qëndrimin e AKEP ndaj komenteve të palëve të interesit në konsultimin publik”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 18.03.2011, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin Nr. 8530 datë 23.09.1999 “Për Shërbimin Postar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brëndshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Miratimin e projektregullores “Për Licencën e Përgjithëshme për ofrimin e shërbimeve postare” dhe qëndrimin e AKEP ndaj komenteve të palëve të interesit në konsultimin publik”

**BAZA LIGJORE:**

1. Nenet 3, pika 21, 7/1 dhe 17 të ligjit Nr.8530 datë 23. 09. 1999 “Për shërbimin Postar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji 8530).
2. Pikën 1 të nenin 114, pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” (ligji 9918)
3. Nenet 1, 2, 106 e në vijim të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave

Administrative” (ligji nr. 8485), i ndryshuar;  
4. Pika 1, germa (e) dhe pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP (ish ERT)” (Rregullorja e Brendshme), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues (VKD) të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;

### **K Ë S H I L L I D R E J T U E S:**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Projekt vendimi;
- Relacioni shoqërues i projekt vendimit;
- Projektregullorja “Për Licensën e Përgjithëshme për ofrimin e Shërbimeve Postare”;
- Komentet e dhëna mbi projektregulloren nga palët e interesuara gjatë periudhës së konsultimit publik.

### **V Ë R E N:**

1. AKEP, në zbatim të neneve 7/1 dhe 17 ligjit nr.8530 datë 23.09.1999 “Për shërbimin Postar në Republikën e Shqipërisë “ i ndryshuar, ka ndër te tjera kompetencat për dhënien e licencave në bazë të përcaktimeve ligjore, si dhe miraton procedurat, përmbajtjen dhe pagesat e këtyre licencave. Duke qënë se procedurat për dhënien e “Licensës së Përgjithëshme” përcaktohen nga AKEP, u hartua një projektregullore e cila përcakton këto procedura dhe kushte që duhet të përmbushin sipërmarrësit për t’u licencuar pranë AKEP.
2. Duke qënë se projektregullorja konsiderohet e rëndësishme në aspektin rregullator të tregut të shërbimeve postare ky dokument iu nënshtrua procesit të konsultimit publik për periudhën 24.01.2001-24.02.2011.
3. Gjatë periudhës së konsultimit publik janë paraqitur komente nga ofrues aktual të shërbimeve postare: i) “YOUTH ALBANIA PARCEL SERVICE”, ii) “AC Albanian Courier”, iii) “Rad Mail Security Couriers” dhe iv) “TNT Express Albania.
4. Projektregullorja e paraqitur reflekton disa ndryshime në bazë të komenteve të dhëna.

## **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Bazuar në pikën 1 të nenin 114, pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, germën (c) të nenit 7/1, pikën 2 të nenit 17 të ligjit 8530 i ndryshuar si dhe pikën 17, neni 21 të Rregullores së Brendëshme të AKEP, e ndryshuar,

## **V E N D O S:**

1. Të miratojë Rregullore: **“Për Licencën e Përgjithëshme për Ofrimin e Shërbimeve Postare”** (bashkëgjitur)
2. Të miratojë qëndrimin e AKEP mbi komentet e dhëna nga palët e interesuara gjatë periudhës së konsultimit publik.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R I**  
**Piro XHIXHO**

## **ANËTARË:**

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURÇE**

# RREGULLORE

Nr. \_\_\_\_\_, datë 18.03.2011

## PËR LICENCËN E PËRGJITHËSHME PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE POSTARE

Në mbështetje të shkronjave b) dhe c) të nenit 7/1, e vijues të Ligjit Nr.8530, date 23.09.1999 “Për shërbimin Postar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me ligjin Nr.10132, date 11.05.2009, si dhe të shkronjës p) të nenit 8, dhe pikës 1 të nenit 114 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”

### KËSHILLI DREJTUES I AKEP VENDOSI:

#### KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

##### Neni 1 Objekti

1. AKEP administron dhe jep licencat e përgjithëshme, për ofrimin e shërbimeve postare që nuk përfshihen në shërbimin bazë postar.
2. Kjo Rregullore, përcakton kushtet procedurën dhe pagesat për dhënien e “Licencave të Përgjithshme”, në zbatim të shkronjës c) të nenit 7/1 të ligjit nr.8530, datë 23.09.1999 “Për shërbimin Postar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (këtu e më poshtë Ligji 8530).
3. Dhënia e “Licencave të Përgjithshme” nga AKEP bëhet në përputhje me Ligjin 8530, i ndryshuar dhe rregulloreve të AKEP dhe/ose rekomandimeve të organizmave përkatës postar ndërkombëtare.

##### Neni 2 Fusha e zbatimit

1. Subjektet fizike apo juridike mund të ofrojnë shërbime postare, që nuk përfshihen në shërbimin bazë postar, vetëm pasi të jenë pajisur nga AKEP me “Licencë të Përgjithshme”.
2. “Licenca e Përgjithshme” përfshin të gjithë ose pjesë te stadeve të pranimit, perpunimit (sortimit), transportimit, shpërndarjes dhe dorëzimit të objekteve postare. Shërbimet postare që kryhen sipas kësaj Rregulloreje janë:
  - a. Shërbimi special i dorëzimit të objekteve postare të postës së shpejtë-Posta Expres;
  - b. Shpërndarja e objekteve të paadresuara për publicitet;
  - c. Përgatitja e objekteve postare;
  - d. Shërbime të tjera të kërkuara nga aplikuesi dhe të gjykuara nga AKEP.

**KREU II**  
**PROCEDURA, KUSHTET DHE VLEFSHMËRIA**

**Neni 3**  
**Procedura**

1. Për t'u pajisur me "Licensë të Përgjithëshme", cilido person fizik apo juridik, në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.8530, përcaktimet në këtë rregullore, do të plotësojë Formularin e Aplikimit për t'a paraqitur në Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare (këtu – e mëposhtë AKEP-i). Formulari i Aplikimit për pajisjen me "Licencë të Përgjithëshme" për ofrimin e shërbimit postar do të plotësohet nga web: [www.akep.al](http://www.akep.al).
2. Dokumentacioni mbështetës në lidhje me plotësimin e formularit për ofrimin e shërbimeve postare do të jetë si më poshtë:
  - a) Një deklaratë se personi ka kapacitete profesionale. Kapacitetet profesionale konsistojnë në pasjen e njohurive për sigurimin e nje niveli të përshtatshëm të nivelit të cilësisë për ofrimin e shërbimeve postare.
  - b) Listën e cmimeve që do aplikojë për ofrimin e shërbimeve postare.
3. AKEP do të shqyrtojë aplikimin dhe do të vendosë të japë "Licencën e Përgjithëshme" ose arsyeton për refuzimin e dhënies brenda 30 ditëve nga plotësimi i formularit dhe dokumentacionit të kërkuar (i plotësuar sipas kërkesave të rregullores Ankesi 1). Nëse formulari ose dokumentacioni paraqitet jo i plotë atëherë ai do rikthehet për t'u riplotësuar.
4. "Licenca e Përgjithëshme" do të përmbajë informacionin e mëposhtëm:
  - a. Autoritetin që ka lëshuar "Licencën e Përgjithëshme";
  - b. Numrin dhe datën e "Licencës së Përgjithëshme";
  - c. Emrin dhe adresën e personit fizik ose juridik të cilit i është dhënë "Licenca e Përgjithëshme";
  - d. Të drejtën e dhënë nëpërmjet kësaj "Licence të Përgjithëshme";
  - e. Territorin, në të cilin është dhënë e drejta e ofrimit të shërbimeve postare;
  - f. Afati i mbarimit të "Licencës së Përgjithëshme";
  - g. Kërkesat për pagesat e miratuara nga AKEP; dhe
  - h. Kërkesa të tjera, të cilat lidhen me ofrimin e shërbimeve postare.
5. AKEP do të regjistrojë ofruesin e licencuar në regjistrin e përcaktuar për këtë qëllim. Regjistri do të jetë i disponueshëm edhe elektronikisht.
6. AKEP do të publikojë listën e ofruesve të shërbimeve postare, të cilëve iu është dhënë "Licencë e Përgjithëshme" në faqen e web të tij.
7. AKEP do të vendosë të refuzojë dhënien e "Licencës e Përgjithëshme" për ofrimin e shërbimit postar vetëm nëse ndodhemi në kushtet e mëposhtme:
  - Aplikuesi nuk ka paraqitur dokumentacionin sipas kërkesave të Rregullores;
  - Dokumentat e paraqitur nuk plotësojnë kërkesat e kësaj rregulloreje;
  - Janë paraqitur informacione fallco.

## **Neni 4**

### **Kushtet Kryesore për Ofrimin e Shërbimeve Postare**

1. Personi fizik ose juridik do të ofrojë shërbimet postare vetëm pasi të jetë pajisur me “Licencë të Përgjithëshme” të dhënë nga AKEP.
2. “Licenca e Përgjithëshme” nuk mund t’ju transferohet personave të tjerë pa miratimin paraprak të AKEP.
3. Ofruesi i shërbimeve postare duhet të publikojë;
  - a. Rregullat për ofrimin e shërbimeve postare,
  - b. Llojet e shërbimeve postare;
  - c. Tarifat e shërbimeve të ofruara;
  - d. Afatet kohore të dorëzimit të dërgesave postare;
  - e. Detyrimet e parashikuara nga ofruesit e shërbimit postar;
  - f. Procedurat e shqyrtimit të reklamimeve dhe kompensimet për dëmtim;
  - g. Rregullat për mbledhjen, përpunimin, transportin dhe shpërndarjen e dërgesave postare.
4. Ofruesi i shërbimeve postare duhet të sigurojë konfidencialitetin e korrespondencës.
5. Ofruesi i shërbimeve postare duhet të dorëzojë në pikat postare, drejtuar në vendin e punës apo të studimeve të një personi, vendin e banimit, vendin e shërbimit ushtarak, në spital, sanatorium, në kamp apo vend të burgimit për administratën ose personat e autorizuar prej tij.
6. Ofruesi i shërbimeve postare duhet të evidentojë çmimin e një njësie të çdo shërbimi të ofruar postar dhe numrin e njësisë të çdo shërbimi të ofruar postar në faturat e hartuara me përdoruesit.
7. Ofruesit e shërbimeve postare duhet të sigurojnë ofrimin e tarifave, duke patur parasysh përcaktimet e Këshillit të Minsitrave “Për përcaktimin e tarifës dhe peshës së shërbimeve të rezervuara për Operatorin Publik Postar”.

## **Neni 5**

### **Vlefshmëria e Licencës së Përgjithëshme**

1. “Licenca e Përgjithëshme” do të jepet për një periudhë 10 vjecare me të drejtë rinovimi.
2. Aplikimet për rinovimin e “Licencës së Përgjithëshme” do të bëhen jo më pak se 30 ditë dhe jo më shumë se 90 ditë përpara përfundimit të vlefshmërisë së tij, bazuar në legjislacionin në fuqi të periudhës.

## **KREU III**

### **TRANSFERIMI, NDRYSHIMI DHE REVOKIMI**

## **Neni 6**

### **Transferimi i Licencës së Përgjithëshme**

1. Transferimi i “Licencës së Përgjithëshme” për ofrimin e shërbimeve postare, bëhet vetëm me miratim nga AKEP, pas kërkesës me shkrim nga mbajtësi i Licencës,

dhe vetëm nëse personi fizik ose juridik, të cilit kërkohet t'i kalohet kjo “Licencë e Përgjithëshme” përmbush kërkesat e ligjit nr. 8530 dhe rregullat përkatëse, të zbatueshme nga AKEP-i.

2. Të Licencuarit, i cili kërkon transferimin e “Licencës së Përgjithëshme” për ofrimin e shërbimeve postare një subjekti tjetër, nëse AKEP pranon transferimin, i hiqen të gjitha të drejtat dhe detyrimet e “Licencës së Përgjithëshme” me të cilin ishte pajisur dhe i kalojnë të Licencuarit të ri.
3. Transferimi i “Licencës së Përgjithëshme”, do të bëhet nga AKEP, vetëm nëse janë shlyer pagesat përkatëse nga ofruesi i shërbimeve postare (mbajtës i “Licencës së Përgjithëshme”) deri në momentin që kërkon transferimin.

## **Neni 7**

### **Ndryshimet në Licencën e Përgjithëshme**

1. AKEP-i mund të ndryshojë “Licencën e Përgjithëshme”:
  - a. Nëse kjo kërkohet nga i licencuari;
  - b. Nëse pëson ndryshime legjislacioni për shërbimin postar;
  - c. Në zbatim të akteve ndërkombëtare, të detyrueshme për zbatim në Republikën e Shqipërisë.
2. Në rast ndryshimi të emrit të ofruesit të shërbimeve postare dhe/ose ortakëve/aksionerëve të tij, ofruesi i shërbimeve postare bën me dije me shkrim AKEP, por jo më vonë se 30 ditë dhe shoqërohet me dokumentacionin përkatës që vërteton ndryshimin. AKEP brenda 30 ditëve kryen ndryshimet në “Licencën e Përgjithëshme” të mëparshme dhe e ripajis ofruesin e shërbimeve postare me “Licencën e Përgjithëshme”. Në këtë rast, koha e vlefshmërisë së “Licencës së Përgjithëshme” nuk ndryshon.
3. Në rastet e parashikuara në pikën 1 të mësipërme, AKEP-i lëshon një “Licencë të Përgjithëshme”, e cili përfshin ndryshimet.

## **Neni 8**

### **Revokimi i Licencës së Përgjithëshme**

1. AKEP-i revokon “Licencën e Përgjithëshme” me kërkesën e ofruesit të shërbimeve postare.
2. AKEP-i, revokon një “Licencë të Përgjithëshme” me nismën e vet, në rast se vërteton që:
  - a) Ofruesi i shërbimeve postare ka përfituruar “Licencën e Përgjithëshme” duke dorëzuar të dhëna ose dokumenta të fallsifikuara ose ka fshehur fakte;
  - b) Ofruesi i shërbimeve postare ka shkelur dispozitat e ligjit 8530, i ndryshuar;
  - c) Ofruesi i shërbimeve postare nuk ka zbatuar kushtet e “Licencës së Përgjithëshme”;
  - ç) Ofruesi i shërbimeve postare është likuiduar.
  - d) Ofruesi i shërbimeve postare nuk ushtron (fillon) aktivitetin, e përcaktuar në “Licencën e Përgjithëshme”, brenda një viti nga dita e marrjes së “Licencës së Përgjithëshme”
  - d) Ofruesi i shërbimeve postare ka përdorur “Licencën e Përgjithëshme” për qëllime të ndryshme nga ato të parashikuara në licencë .
  - e) Ofruesi i shërbimeve postare nuk ka zbatuar urdhërat e AKEP për të eliminuar mangësitë e konstatuara nga AKEP, brenda afatit të përcaktuar.

- f) Ofruesi i shërbimeve postare nuk ka kryer pagesat për “Licencën e Përgjithëshme” brenda 30 ditëve nga afati i përcaktuar ose 15 ditë pas njoftimit nga AKEP.

### **Neni 9**

#### **Pagesat për Licencën e Përgjithëshme**

Për ushtimin e veprimtarisë së ofrimit të shërbimeve postare sipas “Licencës së Përgjithëshme” ofruesit e shërbimeve postare duhet të bëjnë pagesat pranë AKEP.

Pagesat për “Licencën e Përgjithëshme” janë vjetore dhe kryhen brenda datës 31 mars të vitit në vazhdim si më poshtë;

Pagesë për “Licencë të Përgjithëshme” për ofrimin e shërbimeve postare- 30.000 lekë /vit

### **Neni 10**

#### **Raportimi për shërbimet postare të ofruara**

Ofruesit e shërbimeve postare do të raportojnë peridikisht në AKEP në periudha 6-mujore (deri më 31 Shtator te vitit në vazhdim dhe deri me 31 Mars te vitit pasardhës);

Në raportim do të përfshihen ndër të tjera;

- a. Lista e emrave dhe adresat e pikave të grumbullimit, në territorin e shërbimit, tarifrat e shërbimeve postare dhe mostrat e identifikimit të dërgesave postare (vulë, etiketë, faturë, etj), të vlefshme në fund të ciklit të raportimit.
- b. Ofruesi i shërbimeve postare do t’i paraqesë AKEP-it edhe cdo informacion tjetër ose të dhëna të nevojshme, për qëllime statistikore, hulumtim të tregut ose kryerjen e detyrave të tjera dhe funksionet e AKEP, deri në fund të periudhës së përcaktuar nga AKEP, nese AKEP e kërkon këtë gjë me shkrim.

AKEP do të analizojë dhe publikojë (në botimet/webpage/raportet e AKEP, etj) përmbledhje informacioni, në lidhje me veprimtarinë e ofruesve të shërbimeve postare.

## **KREU IV**

### **DISPOZITA TRANZITORE**

### **Neni 11**

#### **Dispozita Tranzitore**

1. Të gjitha licencat e lëshuara në mbështetje të Udhëzimit nr. 2181 datë 28.06.2002 “Procedurat për dhënien licence dhe leje për operimin në sektorin postar ne R.SH” do të transpozohen sipas rregullores së re të miratuar, jo më vonë se 3 muaj nga hyrja ne fuqi e kësaj rregulloreje.



## **Hyrja në Fuqi**

Rregullorja hyn në fuqi 15 ditë pas miratimit nga Këshilli Drejtues i AKEP-it.

**FORMULAR****PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE POSTARE NËN REGJIMIN E LICENCËS SË PËRGJITHËSHME**

<input type="checkbox"/>	Fillim aktiviteti/veprimatrie	<input type="checkbox"/>	Ndryshimi i të dhënave të shoqërisë (Adrese, selie, përfaqësuesi ligjor, etj.)
<input type="checkbox"/>	Rinovimi i Licencës egzistuese	<input type="checkbox"/>	Ndryshimi i të dhënave të rrjetit
<input type="checkbox"/>	Mbyllje e aktiviteti/veprimatrie	<input type="checkbox"/>	
<input type="checkbox"/>	Ndryshimi i shërbimeve të ofruara	<input type="checkbox"/>	

**A. TE DHËNA MBI SHOQËRINË**

EMERTIMI : .....		Numri i regjistrimit në AKEP: .....	
(Vetëm për ofruesit e shërbimeve postare që janë të regjistruar)			
EMRI i AKRONUAR: .....			
SELIA E SHOQËRISË: .....			
(RRUGA/ NUMRI, KODI POSTAR, QYTETI, PREFEKTURA, VENDI)			
NIPT: .....	TEL: .....	FAX: .....	
Kodi Fiskal: .....	E-mail: .....	Website: .....	
Fillimi nga: .....	Ndryshimi nga: .....	Mbyllja nga: .....	

**ADRESA E KOMUNIKIMIT.** (ne rast se eshte e ndryshme nga selia e shoqerise)

RRUGA / NUMËR, KODI POSTAR, QYTETI, PREFEKTURA, VENDI : .....	TEL – FAX: .....	E-mail: .....
---	------------------	---------------

**B. FORMA JURIDIKE** (Plotësohet me X apo me ✓ në kutinë respektive)

Person Fizik (Biznes personal) <input type="checkbox"/>	SH.KOL. <input type="checkbox"/>	SH.KOM <input type="checkbox"/>	SH.P.K <input type="checkbox"/>	SH.A <input type="checkbox"/>	TJETER: <input type="checkbox"/>
					(Plotesohet forma e shoqerise .....

**C. LLOJI I LICENCËS SË PËRGJITHSHME TË KËRKUAR** (Plotësohet me X apo me ✓ në kutinë respektive)

LICENCË E PËRGJITHSHME LOKALE (Shërbimet ofrohen brenda territorit të një prefekturave) <input type="checkbox"/>	LICENCË E PËRGJITHSHME RAJONALE (Shërbimet ofrohen në territorin e 2 prefekturave deri në 50% të prefekturave të vendit) <input type="checkbox"/>	LICENCË E PËRGJITHSHME KOMBËTARE (Shërbimet ofrohen në mbi 50% të prefekturave) <input type="checkbox"/>
---	--	---

**C. KOHËZGJATJA E LICENCËS SË PËRGJITHSHME TE KËRKUAR**

Numrin e plotë të viteve kalendarike të vlefshmërisë së Licencës së Përgjithshme duke përfshirë dhe vitin në vazhdim: .....	.....
---	-------

**D. SIGURIMI I KËRKESAVE BAZË**

(Plotësohet me X apo me ✓ në kutinë respektive)

Sigurimi i kërkesave bazë në përputhje me rregullimet e dispozitave të nenit 17, 30, 31 të Ligjit 8530 "Për shërbimin Postar në RSH", i ndryshuar	
PO <input type="checkbox"/>	JO <input type="checkbox"/>

**E. PËRFAQESUESI LIGJOR**

Emri: .....	Mbiemri: .....	Numri kartes së identitetit .....
Adresa (RRUGA/ NUMRI, KODI POSTAR, QYTETI, PREFEKTURA, VENDI) .....		Autoriteti që e ka lëshuar: .....
TEL: .....	FAX: .....	E-mail: .....

**ANEKSI I** (vazhdim)

(Sipas Rregullores "Për licencën e përgjithëshme për ofrimin e shërbimeve postare")

**Ë. TË DHËNA TË OFRUESIT TË SHËRBIMIT – RRJETIT POSTAR**

Nr.	NUMRI në AKEP (*)	TITULLI i AKRONUAR	ADRESA (Rruga/Numri, , Qyteti, Prefektura)	TEL FAX	NUIP Kod. Fiscal	PREFEKTURA KU SHTRIHET SHËRBIMI	ZYRA POSTARE (**)	QENDRA E PËRPUNI MIT (**)	AMBJENTE TË TJERA (**)	PERSONELI i PUNËSUAR PLOTËSISHT	PERSONELI i PUNËSUAR ME KOHË TË PJESËSH ME	MOTOÇI KLETA	AUTOMJETE	AUTOMJET TË TJERA
							PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>	PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>	PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>					
							PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>	PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>	PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>					
							PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>	PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>	PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>					
							PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>	PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>	PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>					
							PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>	PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>	PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>					
							PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>	PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>	PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>					
<b>TOTALI</b>														

Ne rast te mungeses se vendit të shtohet një fletë tjetër

(\* Plotesohet vetëm nëse bëhet fjalë për persona fizik/juridik që diponojnë "Licence të Përgjithshme".

(\*\*Plotesohet me X apo me ✓ në kutinë respektive që është e vlefshme)

ANEKSI I (vazhdim)

(Sipas Rregullores "Për licencën e përgjithëshme për ofrimin e shërbimeve postare")

<b>G. PËRMBAJTJA E SHËRBIMEVE POSTARE</b> (Plotësohet me X apo me ✓ në kutitë respective që janë të vlefshme).	
1. Shërbim special i dorëzimit të objekteve të postës së shpejte, brenda vendit. <input type="checkbox"/>	3. Përgatitje e objekteve postare <input type="checkbox"/>
2. Shperndarje e objekteve të paadresuara për publicitet <input type="checkbox"/>	4. Tjetër (Përshkruaj). ..... <input type="checkbox"/> ..... .....

**H. CERTIFIKATA, KONFIRMIME BASHKALIDHUR** (Nuk aplikohet për ofrues të shërbimeve postare që gjenden të regjistruar në regjistrin e ofruesve të shërbimeve postare)

**a) PERSONA FIZIK**

1. Deklarata se aplikuesi ka kapacitete profesionale. <input type="checkbox"/>
2. Lista e cmimeve që do të aplikohen për ofrimin e shërbimeve postare. <input type="checkbox"/>

ANEKSI I (vazhdim)

(Sipas Rregullores së Licencave të Përgjithshme për ofruesit e shërbimeve postare).

**J. DEKLARATË NËN PËRGJEGJËSINË PERSONALE** (Plotësohet me X apo ✓ në kutinë respektive)

Nëpërmjet këtij akti deklaroj se dëshiroj të ushtroj aktivitetet e lartpërmendura të shërbimit postar dhe kërkoj regjistrimin në regjistrin e ofruesve të shërbimeve postare të administruar nga AKEP

Nëpërmjet këtij akti deklaroj se **përfundoj ofrimin e shërbimeve postare nën regjimin e "Licencës së Përgjithshme"**

Nëpërmjet këtij akti deklaroj se **janë kryer ndryshimet e të dhënave** të lartpërmendura, sikurse janë evidentuar më lart.

**DEKLAROJ SE:**  
Informacionet që përmban kjo deklaratë e depozituar dhe cdo informacion tjetër që i bashkelidhet asaj, është i saktë dhe i vërtetë dhe si ofrues i shërbimeve postare do të ofroj shërbimet postare që përfshihen në këtë DEKLARATË bazuar në rregullimet e ligjit 8530 "Për shërbimin postar në RSH", i ndryshuar dhe Rregullores "Për licencën e përgjithëshme për ofrimin e shërbimeve postare"

..... / ..... / 20....  
Nënshkrimi i përfaqësuesit ligjor  
& vula e ofruesit të shërbimeve postare

.....





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Kabineti-**

---

**Qëndrim i AKEP në lidhje me komentet për Projektregullore "Për Licencën e Përgjithshme për ofrimin e shërbimeve postare"**

Në adresë të AKEP kanë ardhur komente nga 4 ofrues të shërbimeve postare, të cilëve u referohemi me "Ofruesi i shërbimeve postare "A", "B", "C" dhe "D"

**I. Komete të ofruesit të shërbimit postar "A"**

**Koment 1 :** Pas nje analize te Projekt Rregullores verejme se ne piken 6 te nenit 4 ofruesit te shërbimeve postare i kerkohet te evidentojë ne faturat e hartuara per klientet cmimin e cdo njesie shërbimi postar te ofruar.

Jemi te mendimit qe AKEP nuk mund te percaktojë dhe fiksojë cmimet e aplikueshme nga ofruesit e shërbimeve postare, dhe per pasoje nuk mendojme se faturat e hartuara per klientet jane nje informacion i nevojshem me qellim permbushjen nga ana e AKEP te funksione te tij sipas legjislacionit te zbatueshem. Kjo, per arsye sepse ne baze te ketij te fundit, ofruesit te shërbimeve postare i kerkohet te publikojë cmimet per shërbimet e ofruara, dhe kjo permbush detyrimet qe legjislacioni percakton per ofruesin e shërbimeve ne menyre qe t'i lejojë AKEP permbushjen e funksioneve qe i percakton ligji.

**Qëndrimi i AKEP :** Në pikën 6 te nenit 4 theksohet "*Ofruesit e shërbimeve postare duhet të evidentojë çmimin e një njesie të çdo shërbimi të ofruar postar dhe numrin e njesive të çdo shërbimi të ofruar postar në faturat e hartuara me përdoruesit*". Qëllimi i kësaj pike të nenit është evidentimi i respektimit të zonës së rezervuar të operatorit publik postar "Posta Shqiptare". Fatura drejtuar subjektit përfitues të shërbimeve postare duhet të hartohet për cdo copë e fatuar me cmimin sipas ndarjeve për gram/kg etj.

**Koment 2 :** Gjithashtu veme re se ne piken 7 te nenit 4 te Projekt Rregullores i behet reference : "...percaktimit te Keshillit te Ministrave " Per percaktimin e tarifës dhe peshës se shërbimeve rezervuara per Operatorin Publik Postar"".

Kjo Projekt Rregullore zbatohet ndaj subjekteve te cilat ofrojne shërbime postare qe nuk perfshihen as ne shërbimin baze postar dhe as ate te rezervuar per Operatorin Publik Postar. Per rrjedhoje sa kohe shërbimi i ofruar sipas Projekt Rregullores eshte nje shërbim i cili nuk cenon dhe eshte i ndryshem nga shërbimi i rezervuar per Operatorin Publik Postar, nuk e shohim te nevojshem dhe te arsyeshem qe per efekt te caktimit te tarifave per ofrimin e shërbimit sipas Licenses se Pergjithshme ofruesi i shërbimit postar duhet t'i referohet tarifave te percaktuara per shërbimin e rezervuar per operatorin publik postar.

**Qëndrimi i AKEP:** Në ligjin nr. 8530, datë 23.09.1999, "Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar neni 3 pika 14 citon: "*Shërbime te rezervuara*"

nënkupton shërbimet e kryera ekskluzivisht nga operatori publik i postave, për të përmbushur detyrimin e shërbimit baze për pranimin, përpunimin, transportin dhe dorëzimin e objekteve të korrespondencës së brendshme, me çmim dhe kufi peshe, siç përcaktohet në vendimin e Këshillit të Ministrave." Aktualisht me VKM nr.788, datë 26.11.2004, është përcaktuar tarifa dhe pesha për shërbimet e zonës së rezervuar që sipas pikës 1 të kësaj VKM: "Tarifa e shërbimeve të rezervuara, të kryera nga operatori publik postar, për pranimin, përpunimin, transportin dhe dorëzimin e objekteve të korrespondencës së brendshme, të jete me e vogël se trefishi i tarifave publike për një objekt të korrespondencës për peshën me të vogël të kategorisë së standardeve me të shpejta, nëse ka kategori të tilla, me kusht që pesha e tyre, të jete me e vogël se 100 gram" . Tarifa dhe pesha e përcaktuar në VKM shërben si bazë për caktimin e tarifave për shërbimet e tjera të liberalizuara dhe që janë në fushën e zbatimit të kësaj rregulloreje. Për momentin tarifa e një njësie postare për ofruesit e shërbimit postar nuk duhet të jetë poshtë 120 Lek/njese dhe pesha jo më e vogël se 100 gr.

**Koment 3:** Ne vijim, vërejmë që perkufizimi që i bëhet në Projekt Rregullore shërbimeve që ofrohen në baze të Licencës së Përgjithshme është i ndryshëm nga ai që përcaktohet në Ligjin nr.8530, datë 23.09.1999 "Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë".

**Qëndrimi i AKEP:** Në ligjin nr. 8530, datë 23.09.1999, "Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar nën 3 pika 20 citon : "Licence e përgjithshme" nënkupton të drejtën që i jepet çdo subjekti fizik ose juridik, vendas apo i huaj, që plotëson kërkesat e legjislacionit shqiptar për shërbimet postare, për ofrimin e shërbimeve të tjera nga ato të rezervuara, që nuk përfshihen në shërbimin baze postar". Në pikën 2 të nenit 2 "Fusha e Zbatimit" të projektregullores jepen shërbime të tjera nga ato të rezervuara, që nuk përfshihen në shërbimin baze postar. Gjithashtu pika 5, germa (d) citon : "Shërbime të tjera të kërkuara nga aplikuesi dhe të gjykuara nga AKEP" d.m.th nëse ky shërbim është tjetër nga ai i rezervuar që nuk përfshihet në shërbimin baze postar.

**Koment 4:** Me tej do të sugjeronim përdorimin në Projekt Rregullore të një terminologjie të unifikuar. Me konkretisht "ofruesit të shërbimeve" diku referohet me emërtimin "sipermarres" diku me perkufizimin "Ofruesi i Shërbimeve Postare" dhe diku me "i Licencuar" (pika 2 e nenit 7)

**Qëndrimi i AKEP:** Komentin konsiderohet i saktë dhe është marrë parasysh në variantin përfundimtar të projektregullores.

**Koment 5:** Në pikën 2 të nenit 7 të Projekt Rregullores përcaktohen rregullat për ndryshimin e emrit të ofruesit të shërbimeve. Pika 2 e këtij neni përcakton që në rast ndryshimi të emrit ose pronareve të ofruesit të shërbimeve postare (kur ky është person juridik), duhet të njoftohet me shkrim AKEP. Në kuadër të perkufizimeve në legjislacionin tregtar, do të sugjeronim zëvendësimin e fjalës pronareve fjalet: "ortakeve/aksionerëve të ofruesit të shërbimeve"

**Qëndrimi i AKEP:** Sugjerimi është i saktë dhe është marrë parasysh në variantin përfundimtar të projektregullores.

## II. Komente të ofruesit të shërbimit postar "B"

Komentet janë të identike dhe me të njëjtën renditje si të ofruesit "A"

### **III. Komete të ofruesit të shërbimit postar “C”**

Komentet janë të identike dhe me të njëjtën renditje si të ofruesit “A”.

### **IV. Komete të të ofruesit të shërbimit postar “D”**

Komentet janë të njëjta me komentet 1, 2 dhe 3 si të ofruesit “A”.